



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



04/ *2043* /2026

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

### RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN SHKURT 2026

Hani i Elezit, 2026

## **DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Shkurt 2026, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Shkurt 2026 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

### **SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA**

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Janar 2026,
- Barazimi me Thesar periudha Janar-Janar2026,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit Janar 2026 në ueb faqen komunale,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit Janar 2026, në dy formate: Word dhe PDF,
- Hartimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit Janar 2026,
- Dorëzimi i PVF 2025 me korrigjim në Departamentin e Thesarit – MFPT,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

## RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN SHKURT 2026

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Realizimi Shkurt 2026
Paga dhe shtesa	202,467.97
Mallra dhe shërbime	17,876.83
Shpenzime komunale	7,812.87
Subvencione dhe trans.	-
Shpenzime kapitale	-
<b>TOTAL</b>	<b>225,673.87</b>

### SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €. Inkasimi i të hyrave për muajin Shkurt është në shumë prej 10,299.90 €.

- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK.

### SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme,

Drejtores për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

*L. Ballazhi*

